



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Kumtesë për Media

Fondi i Grave të Kosovës do të ndajë 63,974.05€ për 17 organizata të udhëhequra nga gratë

E enjte, 10 Nëntor 2016, ora 10:00, Hotel Sirius, Prishtinë

Nesër me 10 nëntor, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) organizon konferencë për media nga ora 10:00 deri në 10:20, për të shpallur zyrtarisht përfituesit e granteve të Fondit të Grave të Kosovës (FGK) me shumën prej pothuajse 64 mijë Euro. Në konferencë do të flasin Drejtorja Ekzekutive e RrGGK, Igballe Rogova, përfaqësuesja nga Austrian Development Agency (ADA), Albulena Zaimi dhe përfaqësuesi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Dario Di Benedetto.

Pas konferencës, RrGGK do të nënshkruaj kontratat me përfituesit e granteve. Këto grante janë mundësuar me përkrahjen e Austrian Development Agency (ADA) dhe Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë.

RrGGK do të ndajë 14 grante për 17 organizata të saj anëtare, tri prej të cilave janë partneritete, me shumën prej gjithsej 63,974.05€. Këto iniciativa do të kontribuojnë direkt në zbatimin e Strategjisë së RrGGK 2015-2018, e cila është përpiluar bashkë me anëtarët e RrGGK.

Përfituesit e granteve të FGK janë:

Grant Avokimi Individual për një Organizatë:

- Aksioni për Nëna dhe Fëmijë me iniciativën: “Avokimi për zgjerimin e kurikulës informative në Qendrat Informuese për shëndetin e gruas dhe trajnimi i stafit në Qendra” (3,995.00€)
- Psikoterapeutët në veprim me iniciativën: “Fuqizimi i grave viktime të dhunës seksuale dhe torturës gjatë konfliktit në Kosovë në regjionin e Gjilanit” (3,595.00€)
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore (KGSC) me iniciativën: “Barazia gjinore drejt anëtarësimit në BE” (3,000.00€)
- Instituti Alpha me iniciativën: “Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe grave të burgosura në Kosovë përmes socializmit të tyre” (3,985.00€)
- Shoqata e Juristëve Norma me iniciativën: “Fuqizimi i gruas nëpërmjet rritjes së transparencës së institucioneve” (3,995.80€)
- OJQ Bliri me iniciativën: “Bëhu pjesë dhe ndihmo në parandalimin e sëmundjeve shekullore” (2,990.00€)
- OJQ Rona me iniciativën: “Avokim për fuqizimin e grave fermere në fshatrat e Malishevës” (3,972.00€)
- Shoqata Iniciativa e Grave me iniciativën: “Koha për frymë të re politike” (3,995.00€)
- Handikos Mitrovica me iniciativën: “Fuqizimi i grave me aftësi të kufizuara përmes rritjes së vetëdijesimit rreth të drejtave të tyre pronësore” (3,946.00€)

- Asociacioni i Grave Fermere “Krusha e Vogël” me iniciativën: “Avancimi i grave dhe vajzave në viset rurale” (3,000.00€)
- OJQ Foleja me iniciativën: “Ngritja e nivelit të edukimit shëndetësor për rëndësinë e planifikimit familjarë dhe shëndetit reproduktiv” (3,675.00€)

Grante Avokimi në Partneritet për Ndryshim:

- Medica Kosova & Djepi i Buzëqeshjes me iniciativën: “Përkrahja e qasjes së nënave vetushqyese të prekura nga lufta në programet e subvencioneve për agrikulturë” (7,915.00€)
- Qendra Për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “Liria” & Legjenda me iniciativën: “Ngritja e pozitës së Gruas në proceset e paqe-bërjes dhe buxhetimi gjinor” (7,927.25€)
- Artpolis & Qendra për Promovimin e të drejtave të grave (QPDG) me iniciativën: “Njohja dhe promovimi i të drejtave të shëndetit riprodhues dhe edukimi seksual përmes artit dhe angazhimit të të rinjëve” (7,983.00€)

Fondi i Grave të Kosovës (FGK) i RrGGK-së ofron grante të vogla për organizatat e grave që nuk kanë qasje në burime të tjera të financimit dhe të cilat kërkojnë të punojnë për të drejtat e grave, veçanërisht për grupet që punojnë në vende rurale dhe/apo personat e marginalizuar. Që nga viti 2012, FGK ka përkrahur 83 organizata, me shumën prej 355,996.15€. FGK ka pasur më shumë se 9138 përfitues, dhe ka kontribuar në së paku 13 ndryshime të politikave drejt përmirësimit të jetës së grave dhe vajzave në Kosovë. Në vitin 2016, Fondi i Grave të Kosovës mbështetet nga Austrian Development Agency (ADA) dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Të bashkangjitur e gjeni agjendën për më shumë detaje.